

Takim pune i ekipit menaxhues të projektit në kuadër të Këshillit Kombëtar të Pagesave (KKP) për “zvogëlim të pagesave në para të gatshme në Kosovë”

Procesverbali i mbledhjes

Ref. 2/2011

Vendi: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK)

Data: 26 janar 2011

Koha: 11:00 – 12:20

Pjesëmarrësit:

Robert Wright, Shef Kryesor Ekzekutiv, RBKO (*kryesues*)
Arzen Çavderbasha, Koordinator i Zhvillimeve DSNP, BQK
Rinor Gjonbalaj, Zyrtar i Mbikëqyrjes DSNP, BQK
Diturie Hoxha, Drejtore Ekzekutive, SHBK
Naim Gashi, Menaxher i Thesarit, PTK Sh.A
Akile Cërnobregu, Udhëheqëse e Departamentit të Pagesave, PCB
Teuta Gazideda, Menaxhere e CM&TMO, RBKO
Makfire Osmani, Menaxhere ekzekutive për marrëdhënie me klient, KUR "Prishtina"
Milot Kelmendi, Menaxher i Performancës dhe Analizës, KEK
Boryana Ivanova Mustafa, Drejtore e Pagesave dhe Thesarit, NLB
Edmond Jashari, Zyrtar i lartë i menaxhimit të marketingut, TEB
Dukagjin Shylemaja, Zëvendës Drejtor, TEB
Ozenc Alkan Asik, Udhëheqëse e Operacioneve Bankare, TEB

Munguan:

Gjylfidane Kadrijaj, Drejtore e Sistemeve Ndërbankare të Pagesave, BQK (*u përfaqësua në takim nga zëvendësi i caktuar për këtë ekipë*)

Samir Lleshi, Ekspert për çështje Fiskale dhe Financiare, OEK (*mungoi pa njoftim paraprak*)

Takimi u fillua në ora 11:00.

Diskutimet dhe prezantimet

- **Miratimi i procesit dhe konkluzioneve të takimit të fundit**

Anëtarët miratuan njëzëri procesverbalin e takimit paraprak të mbajtur më 2 dhjetor 2010.

- **Instrumentet e pagesave dhe терминаlet - Kosova në krahasim me shtetet në Evropën Qendrore dhe Juglindore (prezantim i shkurt)**

Përfaqësuesit e BQK-së prezantuan para të pranishmëve analizën që kishte për qëllim krahasimin e Kosovës me shtetet në Evropën Qendrore dhe Juglindore sa i përket instrumenteve të pagesave dhe terminaleve. Ashtu siç ishte vendosur në takimin e kaluar të ekipit punues, shtetet krahasuese ishin shtetet e Evropës Juglindore: Shqipëria, Mali i Zi, Bosnia, Serbia, Kroacia, Sllovenia, Bullgaria, Maqedonia, Turqia, si dhe dy shtetet në Evropën Qendrore: Republika e Çekisë dhe Hungaria. U krahasuan numri i terminaleve (ATM dhe POS), kartelave bankare (kreditit dhe debiti) si dhe numri i llogarive E-Banking në raport me 1 milion banorë. Po ashtu u krahasuan trendet e rritjes veç e veç për secilin shtet. *Ky prezantim gjendet i bashkëngjitur.*

Disa nga konkluzionet e analizës:

- Kosova ka filluar zhvillimin e sektorit të saj bankar dhe të infrastrukturës së pagesave nga zero pas luftës në vitin '99, shumë më vonë se shtetet në Evropën Juglindore dhe Qendrore.
- Infrastruktura e terminaleve (ATM dhe POS) është në rritje me një ritëm më të shpejtë se rritja mesatare në rajon. Megjithatë, aktualisht sa i përket terminaleve për 1 milion banorë, Kosova ka:
 - **ATM:** Numrin më të vogël të ATM-ve në rajon (161), 5 herë më pak se Sllovenia dhe 2 herë më pak se Maqedonia
 - **POS:** Numrin e dytë më të vogël të terminaleve POS në rajon (2,500)
- Numri i kartelave të pagesave është duke u rritur, megjithatë Kosova është ende prapa vendeve të tjera në Evropën Lindore dhe Qendrore. Kosova është vetëm përpara Shqipërisë sa i përket numrit të kartelave të pagesës për 1 milion banorë.
- Mungesa e ndërveprimit bankar ose ndërlihdjes së rrjeteve të terminaleve në Kosovë shkakton joefikasitet. BQK-ja në bashkëpunim me bankat komerciale dhe akterë të tjerë kanë përgatitur Strategjinë për zhvillimin e Sistemit Kombëtar të Pagesave, i cili merret edhe me pagesat me vlera të vogla (*shtylla 3*). Objektivi i përgjithshëm i strategjisë është të sigurojë ekonominë me një gamë të gjerë të sigurt dhe efikase të shërbimeve të pagesave.
- **Hulumtimi mbi Klientin dhe Tregtarin për të kuptuar çështjet e tyre në lidhje me pagesat jo në para të gatshme**

Ashtu siç ishte vendosur në takimin e kaluar, Z. Robert Wright iu tregoj të pranishmëve përafërsisht sa kushton organizimi i një hulumtimi mbi Klientin dhe Tregtarin për të kuptuar çështjet e tyre në lidhje me pagesat jo-cash. 3 nga 4 kompanitë që janë kontaktuar rreth kryerjes së hulumtimit kanë dhënë çmimet e tyre për hulumtim i cili sillet prej rreth 18-25 mijë euro, dhe kohëzgjatje prej 4-8 javësh. Çmimet janë tentative, dhe vetëm indikator të përafërm të çmimit final të projektit (që pritet të jetë më i ulët).

Ekipi menaxhues vendosi unanimisht se është i nevojshëm kryerja e këtij hulumtimi.

Lidhur me mbulimin e kostos së hulumtimit dhe financimin e tij, u propozua që fillimisht të shikohet mundësia e sigurimit të ndonjë donacioni. Znj. Diturie Hoxha (SHBK) mori përsipër që të komunikojë me donatorë të mundshëm dhe që më së largu deri në mes të muajit Shkurt përmes BQK-së të informojë grupin punues mbi disponueshmërinë e fondeve nga donatori.

- **Pyetje, kërkesa dhe propozime**

Disa nga propozimet e shumta nga përfaqësuesit në takim ishin: propozimi që në grupin punues të ketë përfaqësues të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) si dhe përfaqësues të bizneseve të mëdha përveç kompanive utilitare dhe OEK, të shikohet mundësia e kliringut në valuta të huaja, kërkesa e MPMS që pensionistët të mos kenë kartela bankare, etj.

Përfaqësues të bankave po ashtu theksuan nevojën e standardizimit të kërkesave dhe raportimit të terminaleve POS për tregtarët. Kjo do të mundësonte rritjen më të madhe të shtrirjes së rrjetit të POS terminaleve dhe numrit të pagesave jo – cash. Mundësi e zgjerimit të POS terminaleve shihet në institucione të ndryshme si: regjistrim të veturave, kompani të sigurimit, etj.

Përfaqësuesi i KEK-ut, informojë të pranishmit se nga afërsisht 110,000 klientë në Komunën e Prishtinës, afërsisht vetëm 5,000 klientë paguajnë faturat e tyre përmes bankave komerciale. Hulumtimi mbi Klientin dhe Tregtarin mund të tregojë arsyet e hezitimit të klientëve në pagimin faturave përmes bankave komerciale.

Nga përfaqësuesit e BQK u kërkuar që kërkesat dhe propozimet e tilla të dërgohen me shkrim në adresën zyrtarë të DSNP, BQK: paymentsystems@bqk-kos.org. Këto propozime do të analizohen dhe diskutohen në formë më të organizuar në mbledhjen e ardhshme. Këto propozime mund të ndihmojnë edhe në vendosjen e parametrave për *hulumtimin mbi Klientin dhe Tregtarin*.

Çështjet teknike të cilat janë jashtë fushëveprimit të ekipit menaxhues do të adresohen në KKPN ose në takime individuale.

Propozime nga BQK

1. Marrja e iniciativave dhe aktiviteteve konkrete për reduktim të pagesave në cash nga të gjitha institucionet (banka komerciale, kompani publike, kompani private, agjenci qeveritare, etj.).
2. Nga kompanitë utilitare u kërkuar që të zgjerojnë rrjetin e pikave ku klientët mund të drejtohen për Debitim Direkt pasi që aktualisht kjo bëhet ekskluzivisht në një pikë në zyrat qendrore të kompanive. Kompanitë utilitare po ashtu duhet të hartojnë plane operative për zvogëlim/mbyllje të arkave/sporteleve të tyre që pranojnë cash. (*Vendosja e afateve kohore është i nevojshëm*).¹
3. Nga Bankat Komerciale të zvogëlohen tarifat për shërbimet e pagesave elektronike, si Debitim Direkt, E-Banking, Kos-Giro, etj. Besojmë se të hyrat e humbura nga zvogëlimi i

¹ Kjo çështje është biseduar me zyrtarët e KEK-ut në takimet në BQK gjatë zhvillimit të skemës së Debitimit Direkt.

tarifave do të kompensohen me rritjen e numrit të pagesave. Bankat komerciale po ashtu duhet të organizojnë kampanja të vetëdijesimit si të klientëve po ashtu edhe të tregtarëve (komunitetit të biznesit).

4. Të analizohen praktikat në vendet e tjera të vendosjes së limiteve maksimale për vlerat e pagesave në cash pranë sporteleve të bankave komerciale, dhe të dilet me rekomandime për insitucionet e Qeverisë (MEF).

Përfaqësuesit e BQK i njoftuan të pranishmit me nismat e BQK, si promovimi i skemave Kos Giro dhe Debitim Direkt, organizimi i takimeve informative për komunitetin e biznesit (OEK, IPKO, etj), si dhe analizën në proces për vendosjen e limiteve maksimale për vlerat e pagesave në cash pranë sporteleve të bankave komerciale.

Konkluzionet Takimit dhe Hapat e ardhshëm

- Përkundër faktit se u vlerësua që infrastruktura e terminaleve (ATM dhe POS) është prapa zhvillimeve të vendeve të rajonit si dhe tarifatat për shërbimet e pagesave vlerësohen të larta nga ana e komunitetit të biznesit, mbetet çështje individuale e bankave zgjerimi i rrjetit të terminaleve dhe vendosja e tarifave.
- Përfaqësuesi i SHBK përmes BQK-së do të njoftojë grupin punues më së largu deri në mes të muajit Shkurt për disponueshmërinë e fondeve nga donatorët për kryerjen e Hulumtimit mbi Klientin dhe Tregtarin.
- Është e nevojshme ndërlikohja më e mirë e rrjeteve të terminaleve si dhe ndërveprimi bankar në Kosovë. Kjo parashihet edhe në Strategjinë për zhvillimin e Sistemit Kombëtar të Pagesave (*shtylla 3*).
- Kërkesat dhe propozimet për reduktimin e pagesave në para të gatshme të dërgohen me shkrim në e-mail adresën: paymentsystems@bqk-kos.org. Këto propozime do të analizohen dhe diskutohen në mënyrë të organizuar mbledhjen e ardhshme.

Të bazuara në pyetjet/propozimet e takimit paraprak:

1. Rreth propozimit të përfaqësimit të bizneseve në ekipin menaxhues: Momentalisht, anëtarë nga komuniteti i biznesit janë përfaqësues të kompanive utilitare dhe OEK-ut. Nuk duket edhe aq e nevojshme inkuadrimi i kompanive të tjera. Meqenëse, BQK & SHBK, në koordinim me OEK (anëtarë të ekipit), do të punojnë edhe me komunitetin e biznesit.
2. Rreth propozimit të përfaqësimit të ATK-së në ekipin menaxhues: Kryesuesi i ekipit menaxhues mund të propozoj në Këshillin Kombëtar të Pagesave (KKP) rritjen e ekipit menaxhues me 2 apo më shumë anëtar (psh. nga ATK, Thesari, MPMS apo tjerë).
3. Në kuadër të këtij ekipi punues si dhe ndër projekte tjera të BQK-ës, qëllim është promovimi i interesave të klientëve dhe reduktimit të parasë së gatshme në ekonomi. Objektivi i përgjithshëm është të sigurojë ekonominë me një gamë të gjerë të sigurt dhe efikase të shërbimeve të pagesave.

4. Kërkesa për kliring të pagesave në valuta të huaja: Kjo çështje është jashtë fushëveprimit të ekipit menaxhues. Ajo mund të shqyrtohet/propozohet në takimet individuale, ato të KKPN-së apo si propozim përmes SHBK-ës.
5. Kërkesa e MPMS që pensionistët të mos kenë kartela bankare: Në bazë të kërkesës së disa bankave, BQK-ja do të angazhohet që për këtë çështje të analizohet më detalisht nga akterët e involvuar dhe të dalim me një rekomandim të përbashkët.